

V E N D I M
Nr.12, datë 13.5.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtari
Feti Gjilani,	Anëtari
Franc Jakova,	Anëtari
Alfred Karamuço,	Anëtari
Veli Budo,	Anëtari
Zija Vuci,	Anëtar i“““

me sekretare Drita Filto, në datën 11.5.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.19 Akti, që i përket :

K E R K U E S E : PARTIA BASHKIMI SOCIAL DEMOKRAT I SHQIPERISE, e përfaqësuar nga Z. Shaqir Rexhvelaj.

SUBJEKT I INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga Z. Genc Bektashi.

O B J E K T I

Shfuqizimi i vendimeve nr.342 , datë 4.5.1996 dhe nr.353, datë 6.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që i përkasin zonave të zgjedhjeve nr.17 Lezhë dhe nr.19 Pogradec.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N

Partia e Bashkimit Socialdemokrat të Shqipërisë, si subjekt elektoral në zgjedhjet e 26 majit të vitit 1996 ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese shfuqizimin e dy vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke parashtruar se kandidaturat e saj për deputetë në Kuvendin Popullor, të paraqitura, njëra në zonën elektorale nr.17 Lezhë për Z. Pjerin Pal Ivanaj dhe tjetra në zonën elektorale nr.99 Pogradec për znj. Valentina Zylfi Bregu, padrejtësisht janë quajtur të parregullta për t'u regjistruar në listat njëemërore.

Kërkesa e këtij subjekti elektoral është e drejtë vetëm përse i përket kandidaturës për deputet të z. Pjerin Ivanaj.

U vërtetua se kërkesa për regjistrimin e kësaj kandidature së bashku me dokumentacionin përkatës është depozituar në Komisionin e zonës elektorale nr.17 në datën 26.04.1996. Ky fakt rezultoi nga vetë përmbajtja e Vendimit nr.343, datë

04.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si edhe nga procesverbali datë 30.04.1996 i mbajtur në Komisionin e Zonës.

Në të dy këto akte është pasqyruar në mënyrë të përgjithshme dhe të papërcaktuar se si shkak i vetëm i mosregjistrimit të z. Pjerin Ivanaj si kandidat për deputet, ka qenë “parregullsia e dokumentacionit të paraqitur në komisionin e zonës. Megjithatë, as ky as Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk kanë treguar se ku konsistojnë konkretisht këto parregullsi.

Është kërkesë ligjore që Komisioni Qendror të verifikojë pretendimet e subjekteve kundër vendimeve ose veprimeve të komisioneve të zonave dhe të japë vendim të motivuar.

Meqënëse këto kërkesa nuk janë zbatuar, vendimi i tij nr.343, datë 4.5.1996, duhet të shfuqizohet , dhe kërkesa për regjistrimin e këtij kandidati t'i dërgohet komisionit të zonës nr.17 Lezhë.

Përse i përket kërkesës për shfuqizimin e Vendimit nr.373, datë 6.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që i përket zonës nr.99 Pogradec, shkaqet e parashtruara nga Partia e Bashkimit Socialdemokrat, janë të pabazuara.

Në zbatim të shkronjës “d” të nenit 20 të Ligjit nr.8055, datë 01.02.1996, i cili ka ndryshuar nenin 36 të Ligjit nr.7556, datë 04.02.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit

Popullor”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka ushtruar kontroll për regjistrimet e kandidatëve të bëra në zonën nr.17 Pogradec. Gjatë këtij kontrolli ai ka konstatuar se Znj.Valentina Bregu është

regjistruar si kandidate për deputete, më datë 03.05.1996,

pra tej afatit të parashikuar nga neni 13 i Ligjit “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor”.

Në këto rrethana, ai duke e shqyrtuar çështjen kryesisht me të drejtë ka vendosur shfuqizimin e vendimit të komisionit të kësaj zone.

Znj. Valentina Bregu është propozuar nga ky subjekt elektoral si zëvendësuese e një personi tjetër që kishte hequr dorë nga kandidatura për deputet, por ashtu siç ka pranuar me të drejtë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, komisioni i zonës elektorale nr.99, nuk ka pasur parasysh faktin se kandidati që hoqi dorë, nuk ishte regjistruar deri në datën 26.04.1996, dmth., 30 ditë përpara zgjedhjeve. Për rrjedhojë mosrespektimi i këtij kushti, kur janë rastet e parashikuara nga neni 18 i ligjit të sipërpërmendur, i heq të drejtën subjektit elektoral për të regjistruar si zëvendësues kandidatë të tjerë.

PËR KËTO ARSYE :

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 50 të

Ligjit Nr.7556, datë 4.11.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së

Shqipërisë”, ndryshuar me nenin 27 të Ligjit Nr.8055, datë 1.2.1996 “Për ndryshimet në Ligjin Nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet në Kuvendin Popullor të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I :

Shfuqizimin e Vendimit nr.343, datë 4.5.1996 të Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve dhe detyrimin e komisionit të zonës elektorale nr.17 Lezhë, të marrë në shqyrtim kërkesën e Partisë së Bashkimit Socialdemokrat për regjistrimin si kandidat të tij për deputet në Kuvendin Popullor të Z. Pjerin Pal Ivanaj.

Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e Vendimit nr.373, datë 06.05.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 13.5.1996

.